



DRITARE NGA EURO DESIGN 70

MË SHUMË DRITË PËR MIRËQENIEN TUAJ




Me rastin e blerjes së dritareve ju qëndroni para marrjes së një vendimi të rëndësishëm. Shumica e sistemeve të profileve të dritareve ofrojnë termoizolim të mirë, si dhe përdorim dhe pastrim të thjeshtë. Për shkak të nxitimit në përditshmëri, rriten edhe nevojat për relaksim dhe pushim brenda 4 mureve të shtëpisë. Kështu që gjatë blerjes së dritareve nuk qëndrojnë në rend të parë vetëm termoizolimi dhe manovrimi.

Dritaret janë sytë e shtëpisë dhe duhet që të sigurojnë sa më shumë dritë në dhomë, pasi që drita është faktori themelor që ndikon në shëndet dhe mirëqenien njerëzore.


Dritaret nga profilet Euro Design 70 ju sigurojnë më shumë mirëqenie në shtëpinë tuaj, pasi që për shkak të gjerësive më të holla në pamje, kombinimi i profileve ju garanton më shumë dritë në hapësirën e brendshme.

Ndikimi i kornizave më të holla të dritareve në bilancin energjetik

Te një sipërfaqe e xhamit prej afërsisht 10 m² e vendosur kah jugu, përmes përdorimit të gjerësive për 20 mm më të holla të profilit të kornizave arrihet një fitim shtesë i energjisë përmes rrezatimit të diellit deri në 86 kWh p.a. (Ug = 1,3 W/m²K, g-vlera = 80 %, rrezatimi 0,9, ndotja 0,9, periudha e ngrohjes = Tetor – Prill, Pozita 48°13' gjerësia veriore). Kjo do të thotë, varësisht prej pajisjes së ngrohjes, një kursim prej afërsisht 8,6 litra naftë për ngrohje. Një reduktim i konsumit të naftës për ngrohje prej 8,6 litra ul emetimin e CO₂ për deri në 22 kg (11/2,6 kg CO₂).



U-Vlerë e vogël = humbje e vogël e energjisë
g-Vlerë më e lartë = më shumë fitim të energjisë



Deri 13%* më shumë derpërtim të dritës përmes sipërfaqeve më të mëdha të xhami

* gjatë përdorimit të gjerësive prej 20 mm më të holla të kornizës dhe adapterit Madhësia e dritares 120/130 cm

Furnizimi i dhomave me dritë natyrale mund të shkaktojë përmirësimin e mirëqenies dhe si rrjedhojë edhe në ngritjen e produktivitetit. Testoni vetë, në një dhomë të ndritshme dhe të mbushur me rreze të ngrohta të diellit, ju menjëherë do të ndiheni komod dhe rehat si në shtëpi. Dritare të mëdha me U-Vlera të mira (<0,8 W/m²K) garantojnë një klimë të këndshme prapa xhamit edhe në dimër, kur jashtë është ftohtë dhe bie borë.

Dritaret nga Euro Design 70 nuk kontribuojnë vetëm në ngritjen e komoditetit - përmes shfrytëzimit të rrezatimeve pasive të diellit kemi edhe një fitim të energjisë dhe përmes kësaj zvogëlim të shpenzimeve. Pasi që, sa më e lartë të jetë g-Vlera e xhamave, aq më shumë energji e rrezatimeve të paraqitura të diellit mund të depërtojë përmes qelqëzimit në brendësi të dhomës.

Sistemi pra është një investim i shkëlqyer në të gjitha aspektet – kursim i shpenzimeve, fitimi i energjisë, duke përfshirë edhe më shumë mirëqenie.

